



Me shumë përpjekje e sakrificë gjatë gjithë sezonit, "Vllaznia B" ia ka dalë të sigurojë sërish qëndrimin në kategorinë e parë. Ekipi i dytë ka luajtur sot pasdite në "Niko Dovana" finalen e play off-it ndaj Orikut dhe ka fituar vetëm falë penalltive me rezultatin 4-3 sepse koha e rregullt dhe shtesa përfunduan 2-2. Djemtë e drejtuar nga trajneri Ervis Kraja kanë arritur të shënojnë me anë të mesfushorit Denis Dyca në minutën e 33-të dhe me këtë gol është mbyllur kjo pjesë. Duhet thënë se në formacionin e parë të ekipit shkodran kanë luajtur në këtë ndeshje edhe emra të tillë si Erjon Vucaj, Arlind Kalaja e Erdenis Gurishta. Në pjesën e parë, ka qenë Denis Dyca që do të zhblokonte shifrat në '33. Me këtë gol do të mbyllej kjo pjesë. Në të dytën, Vllaznia B tentoi të shënonte edhe golin e dytë në mënyrë që ta siguronte fitoren e kësaj ndeshje, por në fakt janë ndëshkuar. Në minutën e 67-të ka qenë Hoxha që ka shënuar për ekipin vlonjat duke barazuar shifrat. Por ky barazim nuk ka zgjatur shumë. Tre minuta më vonë, pra në të 70-tën, ka qenë sulmuesi Belajdi Pusi që ka kaluar sërish në avantazh Vllazninë B. Por kur u duk se çdo gjë do të përfundonte me fitoren e saj, në minutën e 95-të arbitri Meta do të jepte një 11-metërsh për Orikun i cili do të kthehej në gol nga Dhrami. Kjo ka bërë që koha e rregullt të përfundonte në barazim 2-2, duke sjellë kështu edhe shtesat e lojës. Në të parën është akorduar një 11-metërsh për Vllazninë B por nga pika e bardhë Gurishta ka gabuar. 15 minutat e para të shtesës janë mbyllur pa ndonjë gol tjetër dhe e njëjta gjë ndodh edhe në të dytat duke bërë që rezultati përfundimtar pas 120 minutash loje të ishte 2-2. Një rezultat i tillë bëri që të dy ekipet t'i drejtoheshin pikës së 11-metërshit për të përcaktuar fituesin i cili është Vllaznia B që fitoi me rezultatin 4-3. Në penallti, Gurishta, Hajdari, Hallunaj e Bega, ndërsa kanë gabuar Pusi, Kalaja e Vjerdha duke i dhënë mundësi Vllaznise B të fitonte 4-3 dhe të siguronte kalimin në një kategori më të lartë. Një meritë padyshim për këtë sukses kishte portieri Zamir Vjerdha që ka pritur tre 11-metërsha.

© **vllaznia.al**